

marketagent.

Politika e mbrojtjes së të dhënave

I) Politika e mbrojtjes së të dhënave

Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave tuaja personale është shumë e rëndësishme për ne dhe kur ofrojmë shërbimet tona, ne garantojmë përputhshmërinë me dispozitat e Rregullores së Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe të gjitha dispozitat ligjore plotësuese (TKG 2003). Më poshtë ju njoftojmë me detaje për trajtimin e të dhënave tuaja, masat e sigurisë të marra nga ne dhe të drejtat që ju jepen nga GDPR.

II) Shërbimet

Marketagent.com online reSEARCH GmbH ofron në dispozicionin tuaj shërbimet e tij në përputhje me kushtet e përcaktuara më poshtë; fushat me akses të lirë shërbejnë për të siguruar informacionin e duhur. Seksioni "Paneli i pyetësorit" ju lejon të merrni pjesë në projektet kërkimore të tregut dhe të fitoni pikë bonus nga Marketagent, të cilat mund të shkëmbehen për përfitime monetare. Shërbimet tona janë kryesisht pa pagesë për ju, mbledhja e të dhënave personale bëhet vetëm kur është e nevojshme për qëllimin e pjesëmarrjes.

1) Mbledhja e të dhënave personale

Duke përdorur shërbimet tona, nga njëra anë të dhënat zbulohen automatikisht kur vizitohet faqja e internetit nëpërmjet sistemeve tona të përpunimit të të dhënave, këtu bëhet fjalë kryesisht për të dhëna teknike (p.sh. adresa IP, informacioni rreth shfletuesit/sistemit operativ) dhe nga ana tjetër ndodh mbledhja e të dhënave duke i futur ato gjatë regjistrimit në panelin tonë, si dhe gjatë administrimit të llogarisë tuaj si përdorues.

2) Vizita në faqen e internetit, përdorimi i shërbimeve të lidhura

2.a) Qëllimi, përdorimi, përpunimi

Të dhënat për vizitën në faqen tonë të internetit dhe shërbimet përkatëse mblidhen për të siguruar ofrimin e saktë të shërbimeve të internetit, si dhe për qëllime analize (detajet tek pika 4 - "Cookies, analiza e rrjetit, teknologjia e gjurmimit) dhe për qëllime sigurie për të gjurmuar aktivitetin kriminal dhe për të krijuar mbrojtje nga sulmet e hakerave. Për këtë arsye përpunimi i këtyre të dhënave bazohet në zbatimin e masave parakontraktuale (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" e GDPR), nga interesa të ligjshme në ofrimin e shërbimeve sa më të sakta dhe me performancë të lartë (Neni 6, paragrafi 1, germa "f" e GDPR), si dhe një mbrojtje kundër veprimtarive kriminale në internet dhe mbrojtje efektive kundër sulmeve të hakerave nga një detyrim ligjor në këtë drejtim (Neni 6, paragrafi 1, germa "c" e GDPR).

2.b) Fshirja

Të dhënat e mbledhura në këtë kontekst ruhen në sistemet tona për 6 muaj dhe pastaj fshihen. Në rastin e detyrimeve ligjore, sidomos në ekzekutimin e procedurave zyrtare, periudha për fshirje shtrihet në përfundimin e procedurës ose deri në eliminimin e detyrimit ligjor përkatës.

3) Anëtarësimi në panel

Për regjistrimin si pjesëmarrës në pyetësor kemi nevojë për të dhënat tuaja personale (mbi të gjitha: emri, mbiemri, adresa e emailit, rruga, kodi postar, qyteti, datëlindja dhe fjalëkalimi), si dhe një përzgjedhje të të dhënave socio-demografike (si gjinia, madhësia e qytetit, madhësia e

familjes etj.). Për më tepër, ju gjithashtu jepni të dhëna shtesë kur merrni pjesë në projektet e pyetësorit. Kontakti me ju zhvillohet kryesisht nëpërmjet adresës suaj të emailit.

3.a) Qëllimi, kontrata, përpunimi

3.a.1) Regjistrimi, të dhënat bazë

Për t'u regjistruar në panelin tonë online, do të kërkohen të dhënat personale në vijim për procesin e nevojshëm të regjistrimit:

Të dhënat personale	Emri, mbiemri, gjinia, adresa e emailit, gjuha
Të dhënat e adresës	Rruga dhe numri i shtëpisë, kodi postar, qyteti, shteti
Të dhënat socio-demografike	Datëlindja, gjendja civile, numri i fëmijëve, madhësia e familjes, arsimi, statusi i profesionit, dega, të ardhurat neto për familje, pronësia e makinave, ofruesi i telefonisë celulare (opsionale), rajoni/shteti, madhësia e qytetit
Të dhënat e administrimit të llogarisë	Përgjigjja sekrete, fjalëkalimi, numri i celularit, aplikuesi
Të dhënat teknike	Adresa IP, pajisja, shfletuesi/sistemi i operimit

Përpunimi i këtyre të dhënave konsiston në përzgjedhjen për pjesëmarrje dhe vlerësimin e karakteristikave socio-demografike për projektet kërkimore online të tregut, më tej në vënien në dispozicion të menaxhimit të llogarisë së përdoruesit të Marketagent dhe sigurimin e masave të nevojshme të sigurisë bazuar në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale mes Marketagent.com online reSEARCH GmbH dhe panelistit (=pjesëmarrësit në pyetësor) (Neni 6 par. 1 b GDPR).

3.a.2) Pjesëmarrja në pyetësor

Në kryerjen e projekteve kërkimore online të tregut, të dhënat personale, veçanërisht karakteristikat socio-demografike, si dhe vlerësimet dhe opinionet personale grumbullohen në vlerësime dhe rezultate, që do të thotë se të dhënat e përpunuara janë përkatësisht anonime dhe nuk është e mundur t'u referohen individëve të veçantë. Prandaj, nuk bëhet më fjalë për të dhënat personale dhe dispozitat e GDPR nuk janë më të zbatueshme. Mbledhja e të dhënave në pyetësor bëhet me anë të kontributit të pjesëmarrësit në pyetësor dhe me përcaktimin shtesë të të dhënave meta për intervistën (kohëzgjatja e pyetësorit, vendndodhja gjeografike dhe informacione për shfletuesin/sistemin operativ). Përpunimi për përgatitjen e vlerësimeve dhe menaxhimin e të dhënave të pyetësorit bazohet në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale mes Marketagent.com online reSEARCH GmbH dhe panelistit (=pjesëmarrësi në pyetësor) (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" i GDPR).

3.a.3) Bursa e shkëmbimit

Bursa e këmbimit të Marketagent ofron mundësi të ndryshme për shkëmbimin e pikëve bonus të fituara nëpërmjet shërbimeve të Marketagent. Të dhënat e mëposhtme që futen gjatë një shkëmbimi, përpunohen nga ne dhe i përcillen partnerit të këmbimit ose një institucioni bankar zbatues në rast se kjo është e nevojshme për kryerjen e procedurës së këmbimit.

Banka e shkëmbimit	Të dhënat e marrësit (emri, IBAN) tek banka zbatuese
Paypal	paypal–Account: PayPal (Europe) S.à r.l. et Cie, S.C.A., 22-24 Boulevard Royal, L-2449 Luxembourg

Skrill/Moneybookers	Moneybookers/Skrill-Account: Skrill Limited, 25 Canada Square, London E14 5LQ, England (company number 04260907) - UK
---------------------	---

Për përmbushjen e detyrimeve tona në përputhje me kontratën, është i nevojshëm transferimi tek partneri i shkëmbimit (Neni 6, paragrafi 1, germa "b" i GDPR). Për më tepër, në këto raste kemi detyrimin që këto të dhëna të ruhen deri në fund të periudhës së mbajtjes për tatimet (7 vjet) (Neni 6, paragrafi 1, germa "f" i GDPR) dhe, në përputhje me rrethanat, mund t'u përcillen sipas nevojës autoriteteve tatimore, konsulentëve tatimorë ose kompanive të auditimit.

3.a.4) Fshirja

Të dhënat e mbledhura në këtë kontekst ruhen në sistemet tona për kohëzgjatjen e anëtarësisë së panelit dhe fshihen në mënyrë permanente nga Marketagent pas largimit nga paneli. Në rastin e detyrimeve ligjore, sidomos në ekzekutimin e procedurave zyrtare, periudha për fshirje shtrihet në përfundimin e procedurës ose deri në eliminimin e detyrimit ligjor përkatës.

3.b) Transferimi

Në parim nuk ndodh transferimi i të dhënave personale nga Marketagent, përjashtime respektive ekzistojnë vetëm për përpunuesit e përzgjedhur nga Marketagent. Në këtë kontekst, Marketagent garanton përputhshmërinë e të njëjtit nivel të privatësisë si vetë Marketagent, në përputhje me marrëveshjet e bëra me këta përpunues. Përjashtimet janë të përcaktuara në mënyrë të qartë më poshtë:

Analiza e rrjetit	shiko pikën 4 - Cookies, Analiza e rrjetit, Teknologjia e gjurmimit Google Inc. ("Google")
Partneri i bursës së këmbimit	Ekzekutimi i veprimeve të shkëmbimit, shih pikën 3.a.3 – Bursa e këmbimit
zopim	Modulet me funksionalitet bisede për të dërguar kërkesa për suport në Marketagent
Cint –Menaxhimi i panelit për pjesëmarrje në projektet e kërkimit të tregut ndërkombëtar dhe mbledhjes së opinionit	Partneri Cint merr vetëm të dhënat socio-demografike të vendosura në formë pseudonimi, konkluzionet mbi të dhënat personale nuk janë të realizueshme nga partneri; Cint AB, Luntmakargatan 18, SE-111 37 Stokholm, Suedi
Gjeokodim me Bing Maps	Gjeokodimi i datasetit të përdoruesve përmes Bing Maps Rest API (https://spatial.virtualearth.net)

Playtime (adjoe GmbH)	Playtime (adjoe) is a third feature that is integrated with our app. Playtime allows users to earn in-app currency by playing third-party games and collects devices' application usage from users. The processing of the data is necessary to recommend, via system messages, the installation of the app available in Playtime that matches users' interests and calculates the bonuses acquired as a result of users' use of the corresponding apps. For more information, please refer to Playtime (adjoe) https://adjoe.zone/legal/datenschutz.html .
-----------------------	--

3.c) Buletini informativ

Me miratimin tuaj, ne përdorim adresën tuaj të emailit për të dërguar buletin tonë informativ. Ky miratim mund të jepet në procesin e regjistrimit dhe nuk është i detyrueshëm për anëtarësim në panelin e Marketagent. Ju mund të anuloni dërgimin e buletinit tonë në çdo kohë duke çaktivizuar referencën e buletinit në zonën e pjesëmarrësve, duke përdorur funksionin "çregjistrohu" që gjendet në buletin, duke kontaktuar adresën e emailit ose tek mundësitë e kontaktit në pikën III - Kontakti, Autoriteti i mbrojtjes së të dhënave.

4) Të dhënat teknike të vizitës në faqen e internetit

4.a) Cookies

Faqja jonë e internetit përdor "cookies", për ta bërë vizitën në faqen tonë të internetit më tërheqëse dhe për të lejuar përdorimin e disa funksioneve të caktuara. Këtu bëhet fjalë për tekste të vogla që ruhen në kompjuterin tuaj. "Cookies" që ne përdorim fshihen nga kompjuteri juaj gjithmonë pas mbylljes së shfletuesit (Cookies të sesionit). Në raste të caktuara përdoren "cookies" që mbeten në kompjuterin tuaj dhe bëjnë të mundur njohjen e kompjuterit në vizitën e ardhshme (cookies afatgjatë). Këto "cookies" përdoren për të ruajtur zgjedhjet individuale të bëra nga vizitori (p.sh artikujt e ruajtur në një shportë blerjeje), me qëllim që të rikthehen pastaj në gjendjen e lënë kur faqja përkatëse hapet përsëri. Detajet e "cookies" të përdorura në faqen tonë të internetit, si dhe një listë përkatëse mund të gjendet në deklaratën të mohimit të përgjegjësive për "Cookies", të cilën ju mund ta pranoni kur vizitoni faqen tonë të internetit ose nën lidhjen e mëposhtme <https://panel.marketagent.com/About/Cookies>.

Ju mund të vendosni shfletuesin tuaj në mënyrë të tillë që të jeni të informuar për vendosjen e "cookies" rast pas rasti dhe të vendosni të përjashtoni ose pranoni ato. Mospranimi i "cookies" mund të kufizojë funksionalitetin e faqes sonë të internetit. Në pikën e menysë "Ndihma" në shfletuesin tuaj do të gjeni një përshkrim, se si ta caktoni shfletuesin aktual në përputhje me rrethanat dhe të pranoni ose refuzoni "cookies".

4.b) Analiza e rrjetit, teknologjia e gjurmimit

Faqja jonë e internetit përdor Google Analytics, një shërbim analitik i internetit i ofruar nga Google LLC ("Google"), 1600 Amphitheatre Parkway Mountain View, CA 94043, USA. Google Analytics përdor gjithashtu të ashtuquajturit skedarë personalizimi "Cookies", të cilët ruhen në kompjuterin tuaj dhe lejojnë një analizë të përdorimit të internetit nëpërmjet jush. Informacioni i gjeneruar nga këto "cookies" nëpërmjet përdorimit tuaj të kësaj faqeje interneti (përfshirë një pjesë të adresës suaj IP, por kjo në një formë anonime) transmetohet në një server të Google në Shtetet e Bashkuara dhe do të ruhet atje. Google është certifikuar sipas Marrëveshjes së Mbrojtjes së Privatësisë të vitit 2016 ndërmjet SHBA-së dhe Bashkimit Evropian dhe niveli i mbrojtjes së të dhënave është garantuar në përputhje me dispozitat e GDPR. Ne kemi lidhur një kontratë me Google për përpunimin e të dhënave përkatëse. Google përdor këtë informacion për të vlerësuar përdorimin tuaj të faqes, për të përpiluar raporte për aktivitetin në rrjet për operatorët e internetit dhe për të ofruar shërbime të tjera që lidhen me aktivitetin e internetit dhe përdorimin e internetit. Google gjithashtu ua transferon këtë informacion palëve të treta nëse kërkohet me ligj ose nëse palët e treta përpunojnë këto të dhëna në emër të Google. Google kurrë nuk do të shoqërojë adresën tuaj IP me të dhënat e tjera të Google. Ju mund ta parandaloni instalimin e "cookies" duke vendosur programin tuaj të shfletuesit në përputhje me rastin përkatës; megjithatë, vini re se në këtë rast ju mund të mos jeni në gjendje të përdorni plotësisht të gjitha funksionet e kësaj faqeje. Të dhënat do të fshihen në mënyrë permanente nga sistemi i Google Analytics pas 14 muajsh, sipas përcaktimeve të vendosura në Google Analytics. Natyrisht, të drejtat përkatëse sipas GDPR (neni 15-20 i GDPR) janë plotësisht të aplikueshme për ju në këtë rast, konstatimi ndodh në mënyrën e përshkruar në pikën 6. Për më shumë informacion rreth mënyrës së trajtimit të të dhënave të përdoruesit në Google Analytics, shikoni politikën e privatësisë së Google: <https://support.google.com/analytics/answer/6004245>

Edhe në rastin e përdorimit të "cookies" të partnerëve të tjerë ("Cookie i palëve të treta"), ju do të merrni informacionin përkatës në deklaratën për "cookies" në faqet e internetit të shërbimeve të Marketagent, ku shpjegohet natyra dhe shtrirja e përdorimit të këtyre "cookies" dhe ju mund aprovari ose refuzoni përdorimin e tyre. Nëse ju i keni miratuar më parë (Neni 6, paragrafi 1, germa "a" e GDPR), këto "cookies" mund të përdoren gjatë vizitës tuaj në faqen tonë të internetit me qëllim mbledhjen dhe vlerësimin e sjelljes suaj të përdorimit. Sidoqoftë nuk do të përdoret asnjë "cookies" para se të merret pëlqimi juaj. Mospranimi i "cookies" mund të kufizojë funksionalitetin e faqes sonë të internetit.

4.c) Modulet e medias sociale

Ne përdorim module nga rrjeti social "facebook" i drejtuar nga kompania (Facebook Inc., 1601 S. California Ave., Palo Alto, CA 94304, SHBA), e cila do t'ju shfaqë një miniaplikacion "facebook" në faqet e internetit të shërbimeve Marketagent. Për këtë qëllim, ne përdorim një procedurë me dy faza, në të cilën mund të jepni pëlqimin tuaj në përputhje me nenin 6, paragrafi 1, germa "a" të GDPR për përpunimin e të dhënave nga ana e operatorit të rrjetit social. Të dhënat transmetohen tek operatori i rrjetit social vetëm nëse klikoni në një nga ikonat e shfaqura dhe kështu bini dakord për transmetimin e të dhënave tek operatori i rrjetit social. Vetëm pas një miratimi të tillë krijohet një lidhje nga shfletuesi juaj me rrjetin social përkatës.

Rrjeti social merr informacion në lidhje me vizitën tuaj në faqet tona përmes modulit. Nëse jeni regjistruar në "facebook", vizita juaj mund të renditet në llogarinë e rrjetit social. Çdo ndërveprim me modulën mund të ruhet nga operatori i rrjetit. Informacione mbi përdorimin e të dhënave të nxjerra nga rrjeti social përkatës mund të gjenden në faqen e internetit "facebook" në seksionin "Privatësia" ose "privacy" në <https://www.facebook.com/privacy/explanation>.

5) Masat e sigurisë për të dhënat

Ne ofrojmë shërbimet tona duke përdorur standardet e nevojshme dhe të përditësuara të sigurisë për aplikimet online dhe të të dhënave dhe sigurojmë pajtueshmërinë me këto standarde nga të gjithë përpunuesit tanë (Qendrat e të dhënave, ofruesit "cloud"). Në zonën e pjesëmarrësit, të dhënat tuaja janë të koduara gjithmonë përmes procedurës SSL (të paktën 256 bit) nëpërmjet internetit.

6) Të drejtat përkatëse sipas GDPR

Ju keni të drejtën e informimit, korrigjimit, anulimit, kufizimit, transferimit të të dhënave, revokimit dhe kundërshtimit (neni 15 - 20 GDPR). Ju mund t'i aplikoni këto kërkesa në çdo kohë, duke na kontaktuar me kërkesën tuaj. Opsionet e kontaktit janë të shënuara nën pikën III - Kontakt, Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave.

Nëse besoni se përpunimi i të dhënave tuaja bie ndesh me ligjin për mbrojtjen e të dhënave ose nëse pretendimet për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur në një mënyrë tjetër, ju mund të ankoheni tek autoriteti mbikëqyrës. Në Austri ky është Autoriteti për Mbrojtjen e të Dhënave (pika III - Kontakti, Autoriteti për mbrojtjen e të dhënave).

7) Përdorimi nga të miturit

Për të marrë pjesë në pyetësorët tonë është e nevojshme moshë minimale 14 vjeç, sipas rastit mund të kërkojmë një dokument që vërteton moshën, duke dërguar një kopje të mjetit të identifikimit me foto.

III) Kontakti, Autoriteti i mbrojtjes së të dhënave

GDPR – Personi i kontaktit në Marketagent

Përgjegjës: Marketagent.com online reSEARCH GmbH, Mühlgasse 59, 2500 Baden

Përfaqësues: Mag. Thomas Schwabl (GF)

Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave: Mag. Florian Folkmann

tel: +43 2252 909009

mail: dataprotection@marketagent.com

web: <https://www.marketagent.com>

**Autoriteti i mbrojtjes së të dhënave: Autoriteti Austriak për Mbrojtjen e të Dhënave,
Wickenburggasse 8, 1080 Vjenë**

tel: +43 1 52 152-0

mail: dsb@dsb.gv.at

web: <https://www.dsb.gv.at>